



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 40 pika h) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021 i datës 26.09.2008 , Kryetari i Komunës propozon Kuvendit të Komunës që :

Në mbështetje të neneve 12 par. 12.1, dhe 17 pika r) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008 , dhe neneve 9 pika r) , 20 par 20.1, dhe 51 pika b) dhe pika dh) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____ 2023 të miratojë këtë :

PROPOZIM

VENDIM
PËR PËRCAKTIMIN E FESTIVALIT “MËRGATA FEST” SI FESTIVAL
TRADICIONAL I KOMUNËS SË LIPJANIT

I.Me këtë Vendim përcaktohet që festivali “Mërgata Fest “, të jetë festival tradicional i Komunës së Lipjanit.

II. Festivali tradicional “Mërgata Fest “do të mbahet gjatë sezonës verore, çdo vit.

III. Objektivat e këtij festivali janë kryesisht zhvillimi i aktiviteteve të ndryshme nga fusha e kulturës, rinisë dhe sportit në shenjë respekti për mërgimtarët e ardhur për pushime nga shtetet e ndryshme të botës si dhe me qëllim të argëtimit të gjithë qytetarëve të Komunës së Lipjanit.

IV. Për organizimin, kohzgjatjen dhe mbajtjen e këtij Festivali do të kujdeset Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport i Komunës së Lipjanit.

V.Mjetet financiare për organizimin dhe mbajtjen e këtij Festivali do të sigurohen nga buxheti i Komunës.

VI. Ky Vendim hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në Ëëbfaqen e Komunës

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij Propozim-Vendimi është e përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutit të Komunës.

Qëllimi i miratimit të këtij Propozim-Vendimi është që festivali “Mërgata Fest”, të jetë festival tradicional i Komunës së Lipjanit dhe planifikohet të mbahet gjatë sezonës verore, në secilin vit përkatës.

Festivali organizohet në periudhën kur mërgimtarët frekuentojnë qytetin e Lipjanit dhe për këtë arsye quhet “Mërgata Fest”.

Qytetit të Lipjanit i duhen aktivitete të ndryshme të cilat begatojnë jetën kulturore në vend dhe si i tillë festivali “Mërgata Fest” është mirëpritur në vitet e kaluara dhe tani vlersojmë që duhet të i plotësohet edhe statute i këtij aktiviteti: “Mërgata Fest” – Festival Tradicional i Komunës së Lipjanit.

Me këtë Propozim-Vendim është menduar që edhe Komuna e jonë të ketë një Festival tradicional që realizohet enkas gjatë ardhjes së mërgimtarëve nga diaspora me titull “Mërgata Fest”.

Nga të cekurat më lartë, i propozojmë Kuvendit të Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 644/01-46719
Lipjan, më 29.08.2023

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

